



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 266, datë 30.07.2020

PËR
CAKTIMIN NË POZICION NË NIVEL APELI
TË GJYQTARIT Z. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147, pika 1 dhe nenin 147/a, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 86, shkronja “b”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 61, pika 4 dhe 62, pikat 1 dhe 2, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi shqyrtoi kërkesën e gjyqtarit z. {...} për caktimin në pozicion në nivel apeli pas përfundimit të detyrimit kushtetues për qëndrimin në detyrë në Gjykatën e Lartë deri në emërimin e pasardhësit, si dhe zgjedhjen e bërë nga ai ndërmjet pozicioneve të lira në nivel apeli të publikuara me Vendimin e tij nr.260, datë 23.07.2020, mbi propozimin e relatorit të çështjes,

V E N D O S I :

1. Caktimin në pozicion të gjyqtarit z. {...} pranë Gjykatës Administrative të Apelit.
2. Efektet juridike të vendimit sa i përket ushtrimit të detyrës pranë Gjykatës Administrative të Apelit, fillojnë nga data e njoftimit.
3. Efektet financiare të vendimit fillojnë nga data 09.07.2020.
4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR